

LIGJ
Nr.8367, datë 9.7.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7788, DATË 9.2.1994; NR.7899, DATË 2.2.1995; NR. 079, DATË 29.2.1996; NR.8171, DATË 6.2.1997; NR.8248, DATË 6.10.1997; NR.8338, DATË 30.4.1998 DHE NR.8349, DATË 20.5.1998

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.7788, datë 9.2.1994; nr.7899, datë 2.2.1995; nr.8079, datë 29.2.1996; nr.8171, datë 6.2.1997; nr.8248, datë 6.10.1997; nr.8338, datë 30.4.1998 dhe nr.8349, datë 20.5.1998, në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Në shkronjën "A" "Për taksat nacionale", pika "nj" ndryshohet si vijon:

"Për taksat aeroportuale për ulje-ngritje të avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport 3 për qind."

Pika "o" ndryshohet si vijon:

"Për taksën e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë 25 për qind."

Shtohet pika 4 si vijon:

"Shuma që do të përfitojë Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) si agjent tatimor nga të gjitha kompanitë dhe shoqëritë ajrore përdoren për mbulimin e shpenzimeve për veprimtarinë e mbikalimeve ajrore."

Neni 2

Në nenin 9, pika 10, shtohet nënpika "dh" me këtë përmbajtje:

përfshihen nga pagimi i taksave të mbikalimeve ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë avionët ushtarakë dhe avionët e pidentifikuar".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2157, datë 20.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani